



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Prof. dr. Ali Topalli

Nr. Prot. 355  
Datë 03.03.2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", pas shqyrtimit të njoftimit të Dr. Iur. Bashkim Preteni- ligjërues i të Drejtës Noteriale, dt. 25.2.2020, në mbledhjen e mbajtur më 25.02.2020, mori:

**VENDIM**

- I. Për anulimin e vendimit nr. prot. 2319, të datës 19.11.2019, për lejimin e mjeteve për financimin e pjesërishëm të komentarit të Ligjit për Noteri nga Dr. Iur. Bashkim Preteni- ligjërues i të Drejtës Noteriale.
- II. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 7.11.2019, pas shqyrtimit të kërkesës së dekanit të Fakultetit Juridik, prof. ass. dr. Agron Bekës, nr. prot. 2028, dt. 28.10.2019, për financimin e pjesërishëm të komentarit të Ligjit për Noteri nga Dr. Iur. Bashkim Preteni- ligjërues i të Drejtës Noteriale, ka marrë vendim (vendimi nr. prot. 2319, dt. 28.10.2019) për financimin e pjesërishëm të komentarit të Ligjit për Noteri nga Dr. Iur. Bashkim Preteni- ligjërues i të Drejtës Noteriale, pasi botimi i këtij komentari do të ishte shumë i rëndësishëm për studentët e Fakultetit Juridik të UMIB-it dhe do të shërbente si projekt kryesor në fushën e hulumtimeve dhe botimeve në Fakultetin Juridik, duke pasur parasysh se do të kishte edhe logon e UMIB-it.

Në njoftimin e datës 25.02.2020, Dr. Iur. Bashkim Preteni informon se mjetet financiare të ndara nga UMIB për botimin (printimin) e komentarit të Ligjit për Noteri tashmë janë të panevojshme për arsye se promovimi i Komentarit do të bëhet në fillim të muajit Prill 2020, prandaj për shkak të vonësës së aprovimit shtetëror të buxhetit edhe në terma teknik kohor - mbështetja financiare do të ishte jorelevante

Bazuar në këto që u cekën si më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrës për Buxhet dhe Financa;
5. Sekretarit të Përgjithshëm

Prof. dr. Ali Topalli

Kryesues i Këshillit Drejtues

